

Mësimi 1: Përgatitja për Mbledhje dhe Drejtimi i Tyre

Ju mund ta zhvillonit të gjithë mësimin ose ta ndani atë në segmente më të shkurtra. Përshatëni mësimin me rrethanat tuaja vendore dhe nevojat, moshën dhe kuptueshmërinë e presidencës të kuorumit ose klasës suaj.

ZOTI NA FTON TA ORGANIZOJMË VETEN

Lexoni te [Doktrina e Besëlidhje 88:119](#). Diskutoni se si udhëzimi i Zotit “organizoni veten tuaj” zbatohet në mbledhjet e presidencës së kuorumit dhe të klasës. Cilat janë disa gjëra që mund të bëjmë për të organizuar mbledhjet tona?

PLANIFIKIMI PËR MBLEDHJET NA NDIHMON TA ORGANIZOJMË PUNËN E ZOTIT

Ndihmojeni presidencën e kuorumit apo të klasës të plotësojë një [model rendi dite](#) gjatë përgatitjes për mbledhjen e radhës të presidencës. Mbani parasysh të diskutoni së bashku pyetjet vijuese:

- Përse është e rëndësishme të shqyrtohen pyetjet si ato në modelin e rendit të ditës?
- Për çfarë mbledhjesh apo aktiviteteesh të tjera mund të përgatitemi në këtë mënyrë?
- Si mund ta ftojme Frymën e Shenjtë që të na ndihmojë kur planifikojmë dhe drejtojmë mbledhje?
(Shih [Moroni 6:9](#); [Doktrina e Besëlidhje 46:2](#).)

Ju gjithashtu mund të ftoni anëtarët të presidencës të përgatitin një rend dite për mbledhjen e radhës të kuorumit apo klasës që ndjek përvijimin e dhënë në çdo mësim tek [Eja, Më Ndiq – Për Kuorumet e Priftërisë Aarone dhe Klasat e Të Rejave](#). Ftojini ata të mendojnë rreth çështjeve që diskutuan në mbledhjen e tyre të presidencës që nevojitet gjithashtu të diskutohet me anëtarët e kuorumit dhe të klasës. Nëse e lejon koha, mund t’i ftoni të praktikojnë drejtimin e një mbledhjeje duke përdorur një rend dite që kanë përgatitur.

Herë pas here, mund të dëshironi të diskutoni se si u ndien anëtarët e presidencës rreth një mbledhjeje. Si pjesë të këtij diskutimi, ju mund të bëni pyetje si vijueset:

- A e përmbushi mbledhja atë që sinonim?
- Çfarë bëme ne për ta ftuar Shpirtin në mbledhje? (Shih [Doktrina e Besëlidhje 6:32](#).)
- A u përpoqëm ta përfshinim gjithkënd?
- Si mund të përmirësohem?

BURIME MBËSHTETËSE

- *Manuali i Përgjithshëm: Shërbimi në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme*, 10.4, 11.3.4, ChurchofJesusChrist.org